

VENDIM
Nr. 364, datë 24.4.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS FUSHË-ÇIDHËN TË QARKUT TË DIBRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Fushë-Çidhën të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Fushë-Çidhën të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr. 1237, datë 10.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Fushë-Çidhën të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Fushë-Çidhën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Fushë-Çidhën

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
50	Prona që përdoren për realizimin e funksionit në fushën e administratës	Në pronësi
51-56	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën arsimit	Në pronësi
57-62	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit	Në pronësi
63-70	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit funeral	Në pronësi
71-94	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e infrastrukturës rrugore	Në pronësi
96-99,101,102,104,105,106, 108,109,110,111	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësi-ushqimit, toka produkteve	Në përdorim Nuk transferohen sipërfaqet e trajtuara me VKM, nr. 868, datë 18.6.2008
100,103,107,112,134-136	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësi-ushqimit, toka joproduhuese, ujitje, kullim. Mbrojtje nga përmytjet	Në pronësi
115-118	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

